



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar për lëndën e formuar pas denoncimit nga parashtrues i njohur dorëzuar der tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

VENDIM

NDËRPRITET procedura për lëndën numër 12-2148/1 me datë 08.06.2020 formuar me denoncimin e parashtruar nga parashtrues i njohur deri tek KSHPK.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-2148 me datë 08.06.2020 me arsyje që akuzat në denoncim nuk janë vërtetuar.

Lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-2148 me datë 08.06.2020 e formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtrues i njohur.

Në denoncim flitet për akuza për dyshime për paligjësi të ndërmarra nga Naqe Çulev gjatë kohës kur ka ushtruar funksionin e ministrit për punë të brendshme lidhur me furnizimin me dy telefonë mobil në vlerë të përgjithshme prej 173.980 den, gjegjësiht në vlerë të veçantë nga 86.990 den, gjë që nuk është në përputhje me vlerën maksimale të lejuar për telefon në Rregulloren e Ministrisë për punë të brendshme për shfrytëzim të telefonëve celular dhe moduleve identifikues me parapagesë për zyrtarë.

Me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike dhe kontrollimit të akuzave në denoncim, KSHPK dorëzoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve me numër 12-2148/2 me datë 21.10.2020 deri tek Ministria për punë të brendshme me të cilën kërkon në kuadër të kompetencave ligjore të dorëzojnë informacione të plota për atë se vallë në periudhën derisa funksioni e ministrit për punë të brendshme e ka kryer Naqe Çulev janë blerë dy telefona mobil, për cilën vlerë (të përgjithshme dhe të posaçme për çdo telefon) dhe në bazë të cilit akt ligjor është realizuar ai furnizim. Me informacionet të dorëzohet edhe kopje e Rregullores së Ministrisë së punëve të brendshme për shfrytëzim të telefonëve celular zyrtar dhe modele identifikuat zyrtar me parapagesë, i cili ka qenë aktiv gjatëkohës që është bërë furnizimi i përmendur.

Në afatin e caktuar me ligj është dorëzuar përgjigje nga Ministria për punë të brendshme.

Me përgjigjen numër regjis. 18.1.87566/1 me datë 05.11.2020 Ministria për punë të brendshme e informon KSHPK se dy telefonët e blerë për Naqe Çulev, gjatë kohës kur ai ka qenë Ministër i punëve të brendshme, janë marrë nga subvencioni i fituar që mundëson operatori mobil gjatë nënshkrimit të Kontratës për furnizim me shërbime nga telefonja mobile për nevojat e Ministrisë dhe të punësuarve në të. Në drejtim të kontrollimit të mëtutjeshëm për akuzat e lëndës konkrete dhe përcaktimit të gjendjes faktike, KSHPK me Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve numër 12-133/1 me datë 11.01.2021 kërkoi nga Ministria për punë të brendshme të dorëzoj informacione për vlerën e veçant për të dy celularët, të cilët janë blerë për Naqe Çulevin kur ai ka kryer funksionin e ministrit për punë të brendshme.

Në përgjigjen e dorëzuar nga Ministria për punë të brendshme me nr.18.1-4502/1 me datë 20.01.2021 është dorëzuar fatura në të cilën është vlera gjegjësisht vlera e posaçme për të dy telefonat celular të cilët janë blerë për Naqe Çulevin derisa ka kryer funksionin e ministrit për punë të brendshme.

Nga shqyrtimi i faturave të dërguara është theksuar se vlera e veçantë për telefonin celular është 73.720 den pa TVSH, ose gjithsej vlera për dy telefonët celular është 147.440,68 den pa TVSH, me çka është dhënë lirim prej 147.439,83 denarë dhe gjithsej për pagesë prej 1,00 denarë.

Duke pasë parasysh të shënuarën më sipër, KSHPK pas shqyrtimit të dokumentacionit të marrë nga Ministria për punë të brendshme konstaton se dy telefonët celular të cilët janë blerë për Naqe Çulevin, gjatë kohës kur e ka kryer funksionin e Ministrit për punë të brendshme, janë blerë nga subvencioni i fituar që e mundëson operatori mobil gjatë nënshkrimit të Kontratës për furnizim me shërbime nga telefonja mobile për nevojat e Ministrisë dhe për të punësuarit në të, përshkak që akuzat në denoncim nuk janë vërtetuar dhe prej këtu përfundon se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK në rastin konkret dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasysh të theksuarën më sipër, Komision shtetëror për parandalim të korrupsionit, vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM ТЁ KORRUPTIONIT
Zëvendës-Kryetarë: m-r Shemshi Sallai**

Pas përfundimit të seancës së KSHPK
Përpunoi: m-r I. P.